



Prokurimi publik

Matja e performancës

PËRMBAJTJA

- [Cila është arsyeja për matjen e performancës në prokurimin publik?](#)
- [Cilat janë përfitimet e menaxhimit efektiv të performancës?](#)
- [Si të matet performanca](#)
- [Metodologjitë për matjen e performancës në nivele të ndryshme të sistemit të prokurimit publik](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Cila është arsyeja për matjen e performancës në prokurimin publik?

Kontratat e prokurimit publik përbëjnë një pjesë të madhe të produktit të brendshëm bruto (PBB) dhe të buxhetit të shpenzimeve publike të çdo vendi. Sipas *Shqyrtimit Vjetor të Zbatimit të Prokurimit 2013* të Komisionit Evropian, prokurimi publik në Bashkimin Evropian (BE) llogariten të jetë 19% të PBB-së së BE-së në vitin 2011. Këto nivele të shpenzimeve japin arsye të forta për të analizuar ecurinë e operacioneve të prokurimit publik në të gjitha nivelet.

Objekivi parësor i sistemit të prokurimit publik të një shteti është që të ofrojë efikasitet dhe "vlerën e parasë" në përdorimin e fondeve publike duke iu përmbajtur kërkesave të BE-së dhe ligjeve e politikave kombëtare. Matja e performancës kërkon t'i përgjigjet pyetjes themelore se nëse sistemi i prokurimit dhe operacionet realizohen përfundimisht në përputhje me objektivat kryesore të vendosura.

Janë tri nivele të ndryshme të matjes së performancës në kuadër të sistemit të prokurimit publik të cilat janë gjerësisht të identifikueshme.¹ Ka lidhje të ngushtë në mes të tri niveleve në drejtim të ndërvarësisë së performancës. Megjithatë, nevojat, objektivat dhe metodologjitë për matjen e performancës mund të ndryshojnë.

- **Niveli (meta) kombëtar** - vlerëson performancën e sistemit kombëtar të prokurimit publik;
- **Niveli (makro) i autoritetit kontraktues** - vlerëson performancën e operacioneve të autoriteteve kontraktore;
- **Niveli (mikro) i menaxhimit të kontratës** - vlerëson realizimin e një kontrate individuale.

Cilat janë përfitimet e menaxhimit efektiv të performancës?

Në lidhje me tre nivele të ndryshme të matjes së performancës të identifikuar më sipër përfitimet kryesore të menaxhimit efektiv të performancës janë të përshkruara më poshtë.

Niveli (meta) kombëtar: informacion i cilësisë së mirë për performancën (standardin ose cilësinë) e sistemit të prokurimit publik në nivel kombëtar:

- Ndhmon politikëbërësit për të kuptuar se si ndërveprojnë qëllimet e ndryshme të politikave dhe sa ndikojnë politikat në performancën e përgjithshme të sistemit të prokurimit;
- U mundëson qeverive dhe parlamenteve që të përmirësojnë cilësinë e vendimmarrjes dhe të ndërmarrin veprime konstruktive dhe afatgjata që do të zhvillojnë në mënyrë shumë efektive sistemet e tyre të prokurimit publik (për shembull, në aspektin e politikave të prokurimit dhe reformën rregullatore, zhvillimin institucional dhe forcimin e kapaciteteve);
- U siguron qeverive stimuj të fortë për të përmirësuar sistemin e tyre të prokurimit publik dhe i ndihmon ato që të përcaktojnë prioritetet për veprimet e reformave në fushën e prokurimit publik dhe të monitorojnë progresin kundrejt objektivave të përcaktuara;
- Jep informacion të vlefshëm për vlerësimin e sistemit të shpenzimeve publike.

Niveli (makro) i autoritetit kontraktues: Sistemi i mirë i matjes së performancës mund të ndihmojë autoritetet kontraktore në zbatimin efikas të qëllimeve dhe strategjive të tyre operacionale dhe në vendim-marrje, pasi:

- Jep informacion që i vë ata në një pozitë më të mirë për të përcaktuar shkallën e efikasitetit dhe efektivitetit të operacioneve të tyre të prokurimit në tërësi dhe në nivel të projekteve individuale, të tilla si projektet e mëdha infrastrukturore;

¹ Komiteti i Kontaktit i Institucioneve të Auditimit Suprem të Bashkimit Evropian futi nivelet meta, makro dhe mikro në broshurën e Auditimit të Prokurimit Publik (2010).

- Identifikon përparësitë dhe mangësitë në operacionet e tyre të prokurimit dhe monitoron përparimin me kalimin e kohës, duke ndihmuar në përcaktimin e prioriteteve të sakta dhe në marrjen e veprimeve të duhura për përmirësimin e zonave të dobëta;
- Formon një pjesë integrale të planifikimit afatgjatë strategjik dhe të operacioneve që përfshin procesin e buxhetit vjetor, menaxhimin dhe zhvillimin e personelit.

Niveli (mikro) i menaxhimit të kontratës: menaxhimi i kontratave në nivel individual të kontratës, dhe lidhja e saj me mekanizmat e pagesës:

- Ofron stimuj për plotësimin e përmirësuar dhe me cilësi të lartë të kërkesave të kontratës;
- Vlerëson nëse një kontratë funksionon në mënyrë efikase dhe a jep apo jo "vlerën e parasë";
- Siguron kontribut të vlefshëm dhe konfirmimin e shkallës në të cilën procesi i prokurimit ka qenë planifikuar dhe menaxhuar në mënyrë efikase, në veçanti në lidhje me:
 - Hartimin e specifikimeve teknike apo termat e referencës;
 - Zgjedhjen e strategjisë kontraktore dhe të modelit të kontratës;
 - Zgjedhjen e procedurës së prokurimit;
 - Vendosjen e përzgjedhjes dhe të kriterëve të shpalljes së fituesit;
 - Kryerjen e vlerësimit të tenderit;
 - Dhënien e kontratës;
- Do të gjenerojë argumente të mira dhe stimuj për ndryshimin dhe përmirësimin e të gjitha pjesëve të procesit të prokurimit dhe të marrëdhënieve të brendshme dhe të jashtme nëpërmjet shqyrtimit të vazhdueshëm të mësimëve të nxjerra;
- Kur standardi krahasues përdoret si masë performance, atëherë niveli (mikro) i menaxhimit të kontratës do të sigurojë që autoriteti kontraktues është në gjendje që të krahasojë performancën dhe rezultatet e veta me autoritetet kontraktore përgjegjëse për lloje të ngjashme operacionesh.

Si të matet performanca

Sfidat: Ngritja dhe drejtimi i sistemeve efektive të menaxhimit të performancës është një çështje komplekse që mund të paraqesë një numër sfidash. Është e dobishme që sfidat përpara të kuptohen në avancë dhe të merren parasysh në planifikimin dhe zbatimin e sistemeve të matjes të performancës. Sfidat e mëposhtme janë të zakonshme për sistemet matëse të performancës në të tri nivelet e përshkruara më lart:

- **Qëllime dhe objektiva të qëndrueshme të politikave:** qëllimet dhe objektivat e politikave që ndryshojnë ose janë të paqëndrueshme mund t'i bëjnë sistemet matëse të performancës të pakuptimta dhe mund të veprojnë si pengesë për mundësitë e maksimizimit të rezultatit ekonomik dhe efikasitetit të operacioneve të prokurimit publik. Prandaj, qëndrueshmëria e politikave dhe e objektivave është një element kritik i sigurimit të vlerësimit dhe menaxhimit efektiv të performancës.
- **Informacion statistikor i saktë dhe i besueshëm:** Vlerësimi dhe menaxhimi i performancës varet në të dhënat me cilësi të mirë, të rëndësishme dhe të përshtatshme, të cilat duhet të mbledhen në një mënyrë të fuqishme dhe të qëndrueshme dhe të bazohen në një metodologji të fortë kërkimore. Duhet të bëhen përpjekje të rëndësishme për të siguruar që informacioni i mbledhur shërben për përdorim praktik.
- **Efikasiteti i përcaktuar dhe i matur:** Matja e performancës shpesh kërkon matjen e "efikasitetit", por nuk ka një përkufizim ose mënyrë të vetme me të cilën të matet efikasiteti. Prandaj, duhet treguar kujdes që të garantohet që të ketë një përcaktim të qartë dhe të pranuar.

- **Futja e një kulture të nxitur nga performanca:** mekanizmat rregullatorë dhe institucional mund të ofrojnë disa stimuj për autoritetet kontraktore në mënyrë që ato të përqendrohen për efikasitet të përmirësuar apo performancë më të mirë, edhe pse këto autoritete mund të kërkojnë përmirësime të tilla nëse nxiten nga imperativat ekonomike ose nga shqetësimet që kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë. Prandaj, i duhet kushtuar vëmendje mënyrës me të cilën mekanizmat rregullatorë dhe institucionalë mbështesin vlerësimin pozitiv të performancës.
- **Mbështetje të fortë dhe udhëzime qendrore:** shumë nga faktorët e mësipërm janë të varur nga mbështetja e fortë dhe udhëzime qendrore, si në nivel qendror ashtu edhe në institucione të veçanta. Mund të jetë e nevojshme një fushatë e gjerë informacioni e udhëhequr nga organizata që kanë mandat të qartë si dhe dokumentacion udhëzues dhe mbështetje të nivelit kombëtar. Mund të kërkojë një vendim politik në nivel kombëtar që i detyron autoritetet kontraktore të zbatojnë sistemet e rëndësishme të menaxhimit të performancës dhe të japin informacione të rëndësishme për qëllimet e mblendjes të së dhënave kombëtare.
- **Informacioni i disponueshëm:** informacioni që nuk shpërndahet gjerësisht, mund të mos ketë ndonjë vlerë të përdorimit praktik, dhe për këtë arsye është i rëndësishëm në raportimin e arritjeve dhe rezultateve. Rezultatet dhe gjetjet duhet të paraqiten në një raport vjetor dhe të bëhen të aksesueshme në mënyrë transparente brenda administratës publike për qëllime dhe standarde krahasuese, si dhe për publikun e gjerë. Duke iu referuar objektivave themelore të përcaktuara për sistemin e operacioneve dhe të matjes së prokurimit, raporti duhet 1) të përshkruajë gjetjet kryesore në aspektin e pikave të forta dhe të dobëta të operacioneve të prokurimit publik, dhe 2) të përcaktojë listën e veprimeve të rekomanduara për përmirësimin e sistemit. Rezultatet duhet të jenë pjesë e planifikimit strategjik në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

Shënim: Kërkesat bazë, treguesit e produktit dhe treguesit e mjeteve

Është e rëndësishme që për matjen e performancës në të tri nivelet të krijohen kushtet paraprake bazë dhe të vendosen treguesit e performancës. Shënimi i mëposhtëm jep disa informacione mbi këto aktivitete.

Kërkesat bazë: një aktivitet i rëndësishëm është përgatitja e një *baze* kundrejt së cilës do të matet performanca, ku baza paraqet një standard të zgjedhur në bazë të secilit tregues, kundrejt të cilëve do të bëhet dhe krahasohet vlerësimi. Në parim, baza përfaqëson nivelin e performancës (pranueshmërinë ose rezultati) që duhet të arrihet në një moment të caktuar në kohë. Ajo gjithashtu përbën pikënisjen për të matur shkallën e progresit për një periudhë të caktuar, për shembull, vitin kalendarik.

Treguesit: performanca mund të matet me mjete të ndryshme, në varësi të natyrës së treguesit të përdorur. Treguesit e produktit normalisht mund të maten me anë të një sistemi numerik (për shembull, kursimet ekonomike të arritura), ndërsa treguesit e mjeteve, të tillë si cilësia e kuadrit procedural, normalisht kërkojnë një vlerësim sistematik nga ana e vlerësuesve të kualifikuar, i cili mund të realizohet nga anketat dhe mjetet e ngjashme të grumbullimit të të dhënave.

Synimet e performancës: Komponenti i fundit i sistemit të vlerësimit është vendosja e synimeve të performancës me fjalë ose shifra dhe/ose një kombinim i të dyjave. Qeveria do të përcaktojë disa prej këtyre synimeve si pjesë e objektivave të përgjithshme të zhvillimit të sektorit publik dhe zbatimit të buxhetit, për shembull në aspektin e kursimeve financiare dhe përmirësimin e efikasitetit të ofrimit të shërbimeve publike. Të tilla qëllime (të vendosura në nivel kombëtar) do të duhet të zbatohen nga autoritetet kontraktore, ndërkohë që menaxhimi i autoriteteve kontraktore do të përcaktojë qëllimet operacionale që janë ekskluzive për këto autoritete.

Një ambicie e përgjithshme ka qenë edhe zhvillimi i sistemeve të bazuar në treguesit e performancës, e cila është një metodologji e zakonshme në fushën ekonomike, në mënyrë që të sigurohen informacione dhe udhëzime mbi cilësinë ose realizimin e prokurimit publik. Zakonisht, përzgjedhja e treguesve të performancës është e lidhur me *treguesit e produktit*, ku faktorët sasiorë përdoren në masë të madhe për të matur performancën e një sistemi. Treguesit e produktit tregojnë nëse një sistem punon apo jo në përputhje me një grup të caktuar standard të faktorëve, por ata nuk përipiqen të shpjegojnë se pse është arritur një rezultat i caktuar. Një shembull i një treguesi të produktit në fushën e prokurimit është vlera e treguesve monetarë, siç janë kursimet dhe përmirësimet e efikasitetit. Megjithatë, mbështetja vetëm në treguesit e prodhimit nuk është një metodë e mjaftueshme për të matur standardin dhe progresin e sistemit të prokurimit publik.

Është po aq e rëndësishme që të përfshihen *treguesit e mjeteve dhe të procesit*, pasi që ata hedhin themelet për krijimin e produktit ekonomik brenda sistemit të prokurimit publik. Është shumë e rëndësishme për të qenë në gjendje që të kontrollohet dhe/ose të kuptohet se si është arritur ky produkt në mënyrë që të përfshijë qëllimet e mëdha shtesë prioritare brenda prokurimit publik, të tilla si transparenca, mosdiskriminimi, trajtimi i drejtë dhe llogaridhënia. Instrumentet për të siguruar këto qëllime janë të lidhura tradicionalisht me hartimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, organizimin institucional, dhe mekanizmat për kontrollin dhe ankesat. Treguesit e burimeve mund të vlerësohen vetëm me anë të "*kritereve subjektive*", në bazë të gjykimeve të kualifikuara të dhënë nga profesionistë të pavarur të prokurimit. Shembuj tipikë të treguesve të mjeteve janë statistikave të ndryshme të prokurimit (për shembull, pjesa proporcionale e përdorimit të procedurës së hapur dhe numri vjetor i ankesave) dhe indekset e perceptimit (për shembull, indeksi i kënaqësisë së përdoruesve).

Metodologjitë për matjen e performancës në nivele të ndryshme të sistemit të prokurimit publik

Pjesa në vijim përcakton disa shembuj të metodave që mund të përdoren për të përcaktuar performancën në tri nivelet e identifikuara më lart.

Metodologjitë në nivel (meta) kombëtar

- **Shqyrtimi dhe vlerësimet e kolegëve:** shqyrtim i kolegëve është një instrument i zhvilluar nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), i cili është përdorur për një kohë të gjatë për diagnostikimin e operacioneve të sektorit publik, duke përfshirë prokurimin publik. Ekipi përbëhet nga ekspertë të lartë ndërkombëtarë me përgatitje dhe ekspertizë të gjerë në fushën në fjalë. Qëllimi është që të identifikohen pikat e forta dhe të dobëta (shqyrtimi i performancës) në sistemin e prokurimit, me fokus të veçantë në komponentët kryesorë, të tillë si kuadri legjislativ dhe institucional, organizatat e prokurimit për sa i takon kapaciteteve dhe aftësive, dhe tregjet. Bazuar në analizën dhe konkluzionet, ekipi jep rekomandime për përmirësime aty ku ka nevojë, por i takon vetë vendit që të vendosë mbi veprimet që duhen marrë.
- **Vlerësimi i ndikimit rregullator:** roli i vlerësimit të ndikimit rregullator (VNR) është të sigurojë një vlerësim të detajuar dhe sistematik të ndikimeve të mundshme të një ligji apo rregulloreje të re për të parë nëse ligji apo rregullorja ka të ngjarë që t'i arrijë objektivat e dëshiruara apo jo.
- Shtetet anëtare të BE-së duhet që të implementojnë direktivat e prokurimit² në ligjin e prokurimit publik, kur zbatohen këto direktiva, dhe të sigurojnë që të gjitha dispozitat

² Direktiva 2014/23/BE për dhënie të kontratave të koncesionit, 26 shkurt 2014; Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014; Direktiva 2014/25/BE për

- e tjera të veçanta kombëtare janë në përputhje me rregullat dhe parimet themelore të Traktatit.³ Megjithëkëtë, një Shtet Anëtar ka liri domethënëse për sa i takon mënyrës në të cilën ai zgjedh për t'i zbatuar këto kërkesa në mënyrë të detajuar.
- Nevoja për VNR-në lind nga fakti se rregullimi zakonisht ka ndikime të shumta, të cilat shpesh janë të vështira për t'u parashikuar pa studim të detajuar dhe pa konsultim me palët e prekura. Qasjet ekonomike ndaj çështjes së rregullimit theksojnë gjithashtu riskun e lartë se kostot rregullatore mund të tejkalojnë përfitimet. VNR-ja është kryesisht një metodologji që duhet të përdoret para miratimit të legjislacionit të ri, por nuk ka asgjë që e pengon përdorimin e VNR-së në lidhje me legjislacionin ekzistues si një mjet për fillimin e reformës rregullatore. OECD-ja ka publikuar një numër dokumentesh për përdorimin e metodologjisë së VNR-së (shih më poshtë seksionin e informacioneve të mëtejshme).
 - **Sondazhet e palëve të interesuara:** mund të kryhen sondazhe të rregullta duke trajtuar fusha të rëndësishme dhe çështje të lidhura me performancën e sistemit të prokurimit publik. Këto sondazhe duhet të shpërndahen, sipas rastit, tek një grup i përzgjedhur autoritetesh kontraktore, shoqatat e biznesit dhe operatorët ekonomikë individualë, institucionet e auditimit, universitetet dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm me interes në prokurimin publik. Sondazhet mund të përgatiten dhe të menaxhohen nga zyra e prokurimit publik e vendit, ose nga një organizatë e pavarur apo institucion akademik. Nëse sondazhet përsëriten në mënyrë të rregullt, atëherë ekziston mundësia e kapjes së dallimeve të opinioneve nga një sondazh në tjetrin. Rezultatet e sondazheve duhet të përdoren nga qeveria si bazë për të shqyrtuar mundësinë e ndryshimeve në sistemin e prokurimit në fushat ku janë identifikuar probleme.
 - **Institucionet e auditimit të jashtëm:** Institucionet e auditimit të jashtëm kanë detyra të rëndësishme, në bazë të rregullit *ex post*, në identifikimin e përparësive dhe dobësive në zbatimin e operacioneve të prokurimit publik në nivelin e autoriteteve kontraktore. Auditimet e tyre kanë për qëllim që të përcaktojnë shkallën e përputhshmërisë ose të mospërputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret, si dhe performancën dhe arritjet që janë realizuar në lidhje me objektivat dhe synimet e përcaktuara për një aktivitet të prokurimit.

Metodologjitë në nivel (makro) të autoritetit kontraktues

Metodologjitë në këtë nivel përgatiten me qëllimin e ofrimit të një baze të "praktikës së mirë" për autoritetet kontraktore për mënyrën se si të matet performanca e operacioneve të tyre të prokurimit. Qeveritë mund të përdorin të dhënat që burojnë nga vlerësimi i performancës në këtë nivel me qëllim që të monitorojnë dhe të vlerësojnë operacionet e prokurimit publik dhe me synimin për të nxjerrë përfundime mbi ndikimet e kuadrit ligjor dhe institucional. Rezultatet e sistemit të matjes së performancës në nivel autoriteti kontraktues mund të japin kontribut të vlefshëm në arritjen e përgjithshme kombëtare, të tillë si kursimet buxhetore dhe përmirësimet e përgjithshme të cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike.

Vendosja e synimeve të performancës: Synimet e përdorura të performancës duhet të jenë:

- *Të rëndësishme* - për atë që organizata synon të arrijë;
- *Të atribuueshme* - duhet të jetë e mundur që të ndikohet në veprimtarinë e matur me veprimet që mund t'i atribuohen organizatës, dhe duhet të jetë e qartë se ku qëndron llogaridhënia;

prokurimet nga subjektet në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/17/KE, 26 shkurt 2014; Direktiva 89/665/KEE mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të shqyrtimit për shpalljen fituese të kontratave të furnizimit publik dhe të kontratave të punëve publike, 21 dhjetor 1989, e ndryshuar.

³ Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian - version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, *Gazeta Zyrtare të Bashkimit Evropian*, C 326, 26 tetor 2012. Në Udhëzimin e Prokurimit Traktati referohet si "TFBE" ose "Traktati".

- *Të mirë-përcaktuara* - me një përcaktim të qartë, të kuptueshëm në mënyrë që të dhënat do të mblidhen në mënyrë të vazhdueshme dhe masa do të jetë e lehtë për t'u kuptuar dhe përdorur;
- *Në kohë* – prodhimi i të dhënave në mënyrë të rregullit me qëllim që të ndiqet progresi ashtu edhe në mënyrë të shpejtë që kjo të jetë ende e dobishme;
- *Të besueshme* - mjaftueshmërisht të sakta për përdorimin e tyre të synuar dhe reaguese ndaj ndryshimit;
- *Të krahasueshme* - ose me periudhat e kaluara ose me programe të ngjashme në vende të tjera;
- *Të verifikueshme* - me dokumentacion të qartë në mbështetje të tyre, në mënyrë që proceset që prodhojnë masën të mund të legjitimohen.

Disa shembuj të synimeve, treguesve, dhe matjes së performancës në nivel autoriteti kontraktues

I. Matja e efikasitetit ekonomik

- Kursimet vjetore në para: për mallrat dhe shërbimet për të cilat çmimi nuk luhet me tregun - bazuar në një shportë përfaqësuese të kontratave me një përbërje të njëjtë (në produkt ose shërbim dhe në numër) që siguron llogaritje të qëndrueshme me kalimin e kohës dhe nuk i nënshtrohet ndryshimeve të shpejta të specifikimeve - zhvillimi i çmimit dhe i kostove përcaktohet duke iu referuar vitit 1 dhe zbatohen në të gjithë vëllimin e prokurimit.
- Analiza individuale e çmimeve: për mallrat dhe shërbimet që i nënshtrohen luhatjeve të çmimeve dhe ndryshimeve të shpejta të specifikimeve, të tilla si teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe shërbimet, analiza individuale e çmimeve duhet të kryhet në lidhje me vitin bazë në mënyrë që të përcaktohet shkalla e kursimeve apo e humbjeve.
- Efikasitetet vjetore në para në funksion të prokurimit (përveç çmimit): matja e verifikueshme, kursimet në para duke kryer analiza krahasuese të kosto/përfitimit nga viti X deri në vitin Y të funksionit të prokurimit. Efikasitetet përfshijnë të njëjtat ose rezultate të përmirësuar me më pak burime dhe transformimin e fitimeve të efikasitetit përmes përmirësimeve ose të produktit (p.sh., përmirësime teknologjike) ose të mjeteve (p.sh., bashkëpunimi, logjistika dhe proceset).
- Efikasiteti i zbatimit të projektit/kontratës: për projektet që ndodhin njëherë, të tilla si investimet kapitale dhe projektet infrastrukturore, studimi i fizibilitetit (rasti i biznesit), së bashku me një grup të detajuar të synimeve të performancës, duke përfshirë kostot dhe afatet e zbatimit, përbën bazën kundrejt të cilit matet performanca e projektit.

II. Matja e cilësisë së funksionit dhe e procedurave të prokurimit

Shembuj të treguesve të mundshëm:

- Periudha mesatare për planifikimin dhe përgatitjen nuk duhet të kalojë X ditë.
- Kostoja mesatare për planifikimin dhe përgatitjen e ofertave nuk duhet të kalojë X Euro.
- Procedurat konkurruese, të tilla si procedurat e hapura dhe të kufizuara, duke përfshirë procedurat konkurruese nën kufijtë monetarë të BE-së, duhet të përdoret në jo më pak se X% të numrit të përgjithshëm të procedurave (dhe X %, ku kufiri apo kufijtë tejkalojnë X Euro) .

- Procedurat jo-konkurruese, të tilla si procedura me negociim pa publikim paraprak të njoftimit të kontratës (dhe dhëniet e drejtpërdrejta të kontratave), duhet të mbahen në minimum dhe nuk duhet të kalojë X% të numrit të përgjithshëm të procedurave.
- Norma mesatare e pjesëmarrjes në lidhje me ftesat e hapura gjatë një viti kalendarik nuk duhet të jetë më pak se X ofertuesve ose kandidatëve.
- Numri i kontratave të dhëna për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme normalisht nuk duhet të jetë më pak se X% e numrit të përgjithshëm të kontratave të dhëna gjatë një viti kalendarik.
- Numri i ankesave gjatë një viti kalendarik nuk duhet të kalojë X% të numrit të përgjithshëm të procedurave të kryera të tenderit.
- Përqindja e prokurimit elektronik duhet të jetë jo më pak se X% e numrit të përgjithshëm të tenderave gjatë një viti kalendarik, duke filluar nga viti X.

III. Matja e standardit të marrëdhënieve dhe e bashkëpunimit të jashtëm dhe të brendshëm

Metodat e matjes:

- "Sondazhi i kënaqësisë së furnitorëve" i realizuar në bazë vjetore ka për qëllim të sigurojë se shumica e furnizuesve janë të kënaqur me bashkëpunimin me autoritetin kontraktues.
- "Sondazhi i brendshëm i klientëve" i realizuar në bazë vjetore ka për qëllim të sigurojë se pjesa më e madhe e klientëve të brendshëm janë të kënaqur me shërbimet e organizatës së prokurimit.

Treguesit e mundshëm:

- Indeksi i përbërë nga "kënaqësia e furnitorëve" duhet të jetë më shumë se X në bazë të një shkalle të miratuar dhe duhet të rritet me Y% në vit.
- Indeksi i përbërë nga "kënaqësia e konsumatorëve të brendshëm" duhet të jetë më shumë se X në bazë të një shkalle të miratuar dhe duhet të rritet me Y% në vit.
- Shpenzimet e prokurimit që janë kanalizuar përmes një kontrate/marrëveshje kuadër bashkëpunuese të dhënë nga autoriteti kontraktues, nuk duhet të jenë më pak se X% të vëllimit të përgjithshëm të prokurimit.

Standardi krahasues; standardi krahasues që përfshin studimin krahasues ose analizat e sistemeve të suksesshme të prokurimit të të gjitha ose disa autoriteteve kontraktore, mund të jetë një metodë e shkëlqyer për të ndihmuar në përcaktimin e synimeve të performancës. Të dhënat e standardit krahasues mund të vihen në dispozicion në nivel kombëtar për të siguruar përdorimin e një sistemi uniform të matjes së performancës në të gjithë vendin, gjë e cila mund të lehtësojë gjithashtu edhe krahasimet në nivel kombëtar.

Standardi krahasues është gjithashtu një metodë me të cilën autoriteti kontraktues mund të krahasojë veprimet e veta në aspekte të ndryshme me ndërmarrjet e krahasueshme të jashtme, të tilla si një autoritet kontraktues i ngjashëm i njohur për përsosmërinë e tij. Standardi krahasues mund të përdoret gjithashtu edhe për krahasime të ndryshme të tjera, të tilla si çmimet ose nivelet e shërbimit.

Metodologjitë e nivelit (mikro) të zbatimit të kontratës

Udhëzimi nr. 22 i SIGMA-së për Prokurimin Publik, *Menaxhimi i kontratës*, i cili përshkruan metodologjitë që mund të përdoren për menaxhimin e performancës së kontratave individuale, është i ndarë në tri fusha të gjera: menaxhimi i realizimit, menaxhimi i marrëdhënieve, dhe administrimi i kontratës. Matja e performancës është pjesë e procesit të menaxhimit të kontratës. Matja e performancës së kontratave individuale do të ndjekë në thelb të njëjtën rrugë siç përshkruhet më sipër, duke përcaktuar metodat e mbledhjes së informacionit dhe të dhënave dhe duke përcaktuar fushat e performancës, synimet e performancës, nivelet bazë, treguesit, matjet dhe metodat e analizave.

- Informacion i mëtejshëm

Botimet

SIGMA (2015), *Manuali i Trajnimit për Prokurimin Publik – Moduli G*, Botimet e OECD-së, Paris, <http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>

Udhëzimet e prokurimit publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

SIGMA (2016), *Menaxhimi i kontratës*, Udhëzimi 22, Botimet e OECD-së, Paris

Burime të tjera

OECD (2012), *Rekomandimi i Këshillit për politikat rregullatore dhe qeverisjen* Botimet e OECD-së, Paris, <http://www.oecd.org/gov/regulatory-policy/2012-recommendation.htm>

OECD (2012), “Dokument diskutimi mbi matjet e performancës së prokurimit publik”, Botimet e OECD-së, Paris, http://www.oecd.org/gov/ethics/Discussion%20paper%20on%20public%20procurement%20performance%20measures%20GOV_PGC_ETH_2012_1.pdf

Komisioni i Kontratave të Institucioneve Supreme të Auditimit të Bashkimit Evropian publikoi udhëzimet mbi auditimin e prokurimit publik në vitin 2010, <http://www.tcontas.pt/pt/publicacoes/outras/PublicProcurementAudit.pdf>

Banka Botërore/OECD-DAC, *Metodologjia për vlerësimin e sistemeve të prokurimit (MAPS)*, <http://www.oecd.org/dac/effectiveness/45454394.pdf>

Faqja e internetit të OECD-së mbi një gamë të gjerë çështjesh në lidhje me Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (VNR), <http://www.oecd.org/gov/regulatory-policy/ria.htm>

Faqja e internetit të OECD-së mbi treguesit kryesorë të performancës për prokurimin publik <http://www.oecd.org/gov/ethics/procurement-key-performance-indicators.htm>

Faqja e internetit e Komisionit Evropian mbi rregullimin më të mirë, http://ec.europa.eu/smart-regulation/impact/index_en.htm